



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 90/13
Prishtinë, më 23.01.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Duda Balje, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi dhe Sevdije Lama.

Mungoi: Hasime Krasniqi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki–Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ramadan Avdiu zv.ministër i Financave, Lulzim Rafuna Drejtor Ligjor në Dogana, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 16.01.2013;**
3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë;**
4. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondeve Pensionale të Kosovës;**
5. **Shqyrtimi i Propozimit të Panelit vlerësues të Bankës Qendrore të Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil me Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerjen e FSK-së;**
7. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 16.01.2013**

Kryetarja konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondeve Pensionale të Kosovës

Naser Osmani mendojë që është lëshuar një gabim në nenin 2 pika l ku thuhet se Kuvendi i Kosovës mund të caktojë taksën investive. Në fakt qëllimi i ndryshimit të ligjit ka qenë se Kuvendi cakton taksën operacionale dhe investive. Këto çështje duhet të shikohen gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision.

Hykmete Bajrami neni 1 pika k e parasheh që Kuvendi cakton taksën operacionale dhe investive, ndërsa në pikën l të nenit 2, lenë mundësinë e caktimit të taksës shtesë investive nga Kuvendi nëse kjo vlerësohet e rëndësishme dhe sipas kërkesës së Fondit.

Kryetarja me ligj e kemi rregulluar që Kuvendi është ai që cakton edhe taksën operacionale dhe investive. Megjithatë çdo lëshim që mund të jetë bërë e kemi mundësinë gjatë shqyrtimit të dytë në komision, ku do të agazhojmë grupin punues për të shqyrtuar projektligjin.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondeve Pensionale të Kosovës.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Kryetarja projektligji si i tillë përmban dokumentet e nevojshme si memorandum shpjegues ku shprehen objektivat që synon ky projektligj, deklaratën financiare që vlerësohet se ka kosto shtesë për buxhetin e Kosovës dhe deklaratën për pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-s. Projektligji ka për qëllim përcaktimin e tarifave të posaçme të akcizës për prodhuesit e vegjël të produkteve alkoolike dhe caktimin e metodës për përcaktimin e sasive dhe të përqindjes së alkoolit të produkteve alkoolike

Ramadan Avdiu sqaroi se qëllimi i projektligjit është të ndihmohen prodhuesit alkoolik në Kosovë për prodhimin fillestar dhe pritet që nëpërmjet këtyre masave të ndikohet në përmirësimin e bilancin tregtar dhe zëvendësimin e produkteve të importit me prodhime vendore dhe të nxitet punsimi në këtë sektor. PL me theks të veçantë rregullon deri në çfarë sasi apo cilësie prodhuesit e vegjël vendor alkoolit të jenë të liruar nga tatimi i akcizës dhe të paguajnë tarifë të veçantë për cilësi e sasi. Me projektligji do të caktohen metodat e caktimit të akcizës dhe masat doganore dhe mënyrën e kalkulimit të tatimit dhe akcizës në prodhim. Gjatë hartimit të këtij projektligji, Ministria e Financave ka pasur konsultime e bashkëpunim me të gjitha shoqatat në Kosovë dhe me palët e tjera të interesit.

Naser Osmani a ka ndonjë arsye më bindëse se pse janë bërë këto propozime me këtë projektligj, a është qëllim stimulimi i prodhimit apo rrijta e të hyrave buxhetore?

Lulzim Rafuna përmendi dy arsyt kryesore të procedimit të këtij projektligji, njëra ndryshimi i Rregullores së UNMIK-ut që është e fundit në legjislacionin që zbaton Ministria e Financave. E dyta që të futen nën kontroll prodhuesit në mënyrë që të kontrollohet cilësia e alkoolit. Ndësa për ndikimet në buxhet, ky krijon më pak të hyra se sa me vendos me normat e akcizës. Qëllimi është të mbrohet shëndeti i konsumatorëve përmes kontrollimit të cilësisë së alkoolit dhe stimulimi i prodhuesve vendor për këtë veprimtari dhe jo mbushja e buxhetit.

Latif Gashi mendoj që projektligji ka efekte negative për buxhetin e Kosovës në periudhën afatshkurtër, por me efektete pozitive në periudhën afatmesme sepse do të stimulojë shumë prodhuesit e vegjël dhe prodhimin në Kosovë dhe në të njëjtën kohë do të fus nën kontroll këta prodhues. Mendojë që duhet të përkrahim në parim dhe vërejtjet teknike mund ti diskutojmë përsëri në komision gjatë shqyrtimit të dytë.

Hykmete Bajrami sa i përket stimulimit të prodhuesve të vegjël jam pak skeptike. Ata formalisht nuk paguajn as TVSH, as tatim në fitim dhe Ministria e Financave, administrata tatimore duhet me marrin masa të tjera për me formalizue bizneset në Kosovë. Nuk pajtohem me emrin e projektligjit pasi që është tepër i pakuptimt, ndoshta do të ishte më mirë me qenë prodhuesit e vegjël të produkteve alkoolike. Biznesi që ka filluar që pesë vite nuk është fillestar dhe prap besoj që i gëzon benefitet e këtij ligji.

Latif Gashi theksoi se përkrah mendimin e koleges dhe mendoj që është mirë të ndërrohet titulli dhe të thuhet vetëm për prodhuesit e vegjël dhe të hiqet fillestar, dhe kjo lidhet me sasinë e prodhimit të alkoolit.

Kryetarja gjatë amendamentimit të projektligjit mund të diskutojmë dhe të bëjmë ndryshimet e nevojshme, mendojë të rekomandojmë për miratim në parim dhe pastaj diskutohet më në detale në grupin punues të komisionit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë.

4. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit vlerësues të Bankës Qendrore të Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së

Kryetarja sqaroi procedurën dhe punën e Panelit të BQK-së në përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar joekzekutiv të bordit të BQK-së. Në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore ka emëruar panelin seleksionues për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së, në përbërje: Gani Gërguri, Guvernator i BQK-së, Sejdi Rexhepi, anëtar joekzekutiv i Bordit të BQK-së dhe Fatmir Plakiqi, Drejtor i Thesarit dhe anëtar joekzekutiv, i cili ka publikuar konkursin për plotësimin e kësaj pozite në gazetën ditore në gjuhën shqipe dhe mediat relevante serbe. Pas procesit të selektimit, Paneli ka intervistuar 21 kandidatë dhe në bazë të vlerësimit të kualifikimeve dhe performancës së aplikatëve të ftuar për intervistë, Paneli ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret që kërkojnë me Ligjin e BQK-së. Si rrjedhojë në pajtim me nenin 38.2 të Ligjit për BQK-në, Paneli i ka dërguar Kuvendit dhe Qeverisë listën me emrat e kandidatëve të nominuar për plotësimin e një pozite si anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së dhe atë janë: Bedri Peci i cili është vlerësuar me më së shumti pikë 82.66, Arsim Bruçaj i cili është vlerësuar me 71.66 pikë, dhe Skënder

Kllokoqi i është vlerësuar me 70.33 pikë. Qeveria e Kosovës nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për ti dërguar Kuvendit mendimin për kandidatë e propozuar siç parashihet me nenin 38.2. Në bazë të CV të bashkangjitura, shihet se të tre kandidatët e propozuar nga Paneli i formuar nga BQK, i plotësojnë kushtet dhe kriteret e domosdoshme parapara me nenin 40 të Ligjit të BQK-së, ku parashihet që personat që kualifikohen për t'u zgjedhur që të shërbejnë në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore duhet të jenë me integritet dhe të kenë diplomë universitare si dhe të kenë të paktën dhjetë (10) vjet përvojë profesionale apo akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike.

Latif Gashi une nuk jam për me veçuar ndonjë kandidat por duhet dërguar të tre kandidatët në seancë, pasi që Paneli ka vlerësuar si plotësojnë kushtet ligjore.

Xhevdet Neziraj me që paneli ka vlerësuar se të tre kandidatë i plotësojnë kushtet ligjore, do të ishte mirë ne si komision mos ti ndajmë por ti rekomandojmë të tretë për votim në seancë.

Sali Asllanaj pajtohem me mendimin e Xhevdetit që si komision ti rekomandojmë të tretë për seancë, pasi që Paneli ka qenë shumë profesional, ka zhvilluar të gjitha procedurat ligjore dhe ka vlerësuar se të tretë i plotësojnë kushtet ligjore.

Latif Gashi realisht për t'i ikur votës politike që njëri prej tyre do të ketë në parlament, ai i cili do të llojoj më shumë, mendojë që si komision ti japim përkrahje kandidatit i cili është vlerësuar me më së shumti nga Paneli dhe besojë që është kandidati më profesional.

Hykmete Bajrami është jo profesionale nëse ne e përkrahim njërin nga këta kandidatë dhe besojë që rekomandimi jonë kishte me pas ndikim zero. Ne kemi me u thirrë te grupet parlamentare ata kan me pas favoritet dhe asnjë deputet nuk ka me marrë parasysh rekomandimin e komisionit.

Naser Osmani vlerësimin e ka bërë Paneli dhe e ka bërë renditjes dhe nëse ne ndërhyjmë këtu, duhet të jepet rekomandimin se ky panel nuk ka bërë vlerësim e drejtë dhe të kërkojmë prej Kuvendit kthimin mbrapa ose të përkrahim siq është propozuar nëse vlerësojmë se është respektuar ligji.

Hykmete Bajrami në intervist kanë marrë pjesë 27 kandidatë dhe Paneli i ka proceduar vetëm tre në Kuvend, ne nuk i kemi parë CV-të e tyre. Nuk duhet të merret vetëm kriter përgaditja akademike se nuk po zgjedhim profesor universiteti. Mendojë që për natyrën e punës së BQK-së, eksperiencia është kriter shumë i rëndësishëm. Prandaj mendojë që si komision do të duhej të rekomandojmë që të tre kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore dhe Kuvendi të vendos dhe jo të favorizojmë ndonjërin apo të themi se vlerësimi i Panelit ka qenë korrekt.

Kryetarja ne si komision mund të vlerësojmë kandidatët në bazë të CV se a i kanë përmbushur kushtet ligjore dhe të nxjerrim rekomandimin për Kuvendin. Edhe një gjë që dua ta them se kësaj rradhe nuk kam marrë ndonjë intereferim apo preferencë për ndonjërin nga kandidatët qoftë nga autoritetet vendore apo ndërkombëtare dhe nuk kemi ndikime as nga brenda e as nga jashtë. Mendojë që rekomandimi i komisionit duhet të jetë që Komsioni vlerësoi se kandidatët e propozuar nga Paneli i Bordit të BQK-së për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës, z. Bedri Peci, z. Arsim Bruçaj dhe z. Skender Kllokoqi, përmbushin kushtet dhe kriteret e parapara në nenin 40 të Ligjit për BQK-në, dhe i rekomandon Kuvendit të përzgjedh njërin prej tyre, si kandidatë për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së, me mandat pesëvjeçar. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, në bazë të

nenit 38.2 të Ligjit nr.03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, t’i përcillet Presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandon Kuvendit, të përzgjedhë njërin prej kandidatëve për pozitën e anëtarit joezkektiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, si në vijim:

Bedri Peci,
Arsim Bruçaj,
Skender Kllokoqi.

2. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, t’i dërgohet Presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e anëtarit joezkektiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil me Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerjen e FSK-së

Kryetarja nga analiza që iu është bërë projektligjit dhe amendamenteve të komisionit funksional, shihet se as projektligji dhe as amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi: 11:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona